

**BRITISH COUNCIL ALBANIA
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË**



Thirrje për ekspertë për hartimin e një manuali për lidërshtipin dhe trajnimi mbi lidërshtipin.

Ditë pune: 13

Vendndodhja

Bashkitë Dibër, Kukës, Mat, Bulqizë, Klos, Has, Tropojë, Malësi e Madhe.

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) është institucion i cili garanton dhe promovon të drejtat e të rinjve nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimet e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në bazë dhe për zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

Veprimtaria e AKR-së shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë duke organizuar përgjegjësitë funksionale me qëllim sigurimin e kushteve për mbështjetjen dhe nxitjen e veprimtarive rinore, zhvillimin e dialogut të strukturuar për të realizuar fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri, krijimin e mekanizmave për nxitjen e politikave rinore si dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore e të pavarura, në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve që kanë në fokus rininë shqiptare dhe rëndësinë e kësaj të fundit në shoqëri.

Përshkrimi i Punës

Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe British Council, në kuadër të projektit të “Alternative Pathways”, do të hartoj një manual për krijimin dhe zhvillimin e aftësive të lidërshtip-it të të rinjve. Ky manual synon të pajisë të rinjtë me njohuritë, aftësitë, mjetet dhe strategjitë e lidërshtipit. Gjithashtu, eksperti duhet të zhvilloj një trajnim 3-ditor mbi lidërshtipin rinor.

Termet e Referencës së Manualit të Lidërshtipit.

Manuali duhet të:

- Identifikojë dhe përfshijë teoritë mbi lidërshtip-in rinor, raste studimore si dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Pajisë të rinjtë me aftësi dhe njohuri thelbësore që lidhen me zhvillimin e tyre personal;
- Të zhvillojë aftësitë e mendimit kritik të të rinjve;
- Të fuqizojë të rinjtë të marrin iniciativa dhe të bëhen qytetarë aktivë të komuniteteve të tyre.
- Të trajtojë çështje të etikës në lidërshtip.

Kualifikimet dhe përvojat e Ekspertit:

- Diplomë Master në Shkenca Sociale, Ekonomike, Juridike ose fusha të ngjashme.



Partnership | Progress | Prosperity

- Minimumi 5 vite eksperiencë në pozicione drejtuese.
- Përvojë të mëparshme në zhvillimin e trajnimeve që lidhen me leadershipin.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi.
- Njohje e shkëlqyer e gjuhës angleze.
- Përvojë e mëparshme në zhvillimin e manualeve, udhëzuesve ose programeve trajnimi për të rinjtë.
- Njohuri mbi strukturat, procedurat dhe proceset e Këshillave Vendor Rinor në nivel lokal dhe kombëtar.
- Aftësi të shkëlqyera në kërkim dhe analizë në literaturën ekzistuese për leadership.
- Aftësi për të strukturuar informacionin në mënyrë të qartë dhe të arritshme për të rinjtë.
- Aftësi për të përshtatur trajnimin me nevojat e audiencës.
- Njohuri për kontekstin social të të rinjve në Shqipëri dhe rajon.
- Përvojë në bashkëpunimin me ekipe multidisiplinare dhe aktorë të ndryshëm, përfshirë përfaqësues të organizatave rinore, qeverisë dhe shoqërisë civile
- Gatishmëri për t'u përshtatur me ndryshimet dhe sugjerimet gjatë procesit të zhvillimit të manualeve.

Procesi i Aplikimit

- Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë CV-në dhe një letër motivuese duke detajuar përvojën e tyre relevante deri më datë 11 Tetor 2024 ora 14:00 në adresën e e-mailit: info@rinia.gov.al

Fazat e Vlerësimit

- Fazat për vlerësimin e aplikimeve do të jenë:
 - **Faza 1:** Vlerësimi i Kualifikimeve dhe përvojave bazuar në këtë dokument;
 - **Faza 2:** Intervista me Komisionin e Vlerësimit.

(Aplikantët që kalojnë fazën e parë do lajmërohen zyrtarisht për ditën dhe orën e intervistës).

Afati për Aplikime

Aplikimet duhet të dërgohen deri më datë 17 Tetor 2024 ora 14:00 në adresën e e-mailit: info@rinia.gov.al

Agjencia Kombëtare e Rinisë është një institucion që promovon mundësitë e barabarta dhe inkurajon të kandidatët që plotësojnë kriteret të aplikojnë.

Shënim: Termat e mësipërme të referencës janë dhënë si një udhëzues i përgjithshëm dhe mund të jenë subjekt i modifikimit bazuar në nevojat në zhvillim të projektit.